



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.28, datë 03.10.2018

PËR

DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 1, DATË 30.07.2015

**“PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE QË DO TË NDIQEN
NGA AUTORITETET E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT PËR SHQYRTIMIN E
KËRKESAVE PËR LEJE NDËRTIMI DERI NË MIRATIMIN E PLANEVE TË
PËRGGJITHSHME VENDORE”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:


1. Në pikën 2, të Vendimit të KKT-së Nr. 1, datë 30.07.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga Autoritetet e Zhvillimit të Territorit për shqyrtimin e kërkesave për Leje Ndërtimi deri në miratimin e Planeve të Përgjithshme Vendore”, i ndryshuar, pas shkronjës “g”, shtohet shkronja “h”, me përmbajtje si më poshtë:

h) struktura ku ushtrohet veprimtaria e agroturizimit, sipas përkufizimeve të legjislacionit të posaçëm sektorial;


2. Në pikën 3/1, pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “e”, me përmbajtje si më poshtë:

e) strukturave të agroturizimit, sipas gërmës “h”.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DAMIAN GJIKNURI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
LEDIA TOTA

